

Nëse është e nevojshme ju keni të drejtën të përdorni shërbimet e një përkthyesi. Lutemi na informoni për kërkesat për një përkthyes kur caktoni vizitën tuaj. Personeli i kujdesit ndaj shëndetit do të organizojë një përkthyes nga një agjenci përkthimi.

Të drejtat tuaja të kujdesit shëndetësor

Trajtimet e kujdesit shëndetësor

Mund të krijohen gabime dhe keqkuptime nëse nuk jeni të kënaqur me mënyrën se si jeni trajtuar nga personeli i kujdesit shëndetësor. Përgjegjësitë e kujdesit shëndetësor janë rregulluar në disa ligje dhe legjislacione të ndryshme. Pacientët kanë të drejtën e të marrin kujdes shëndetësor me cilësisë dhe siguri. Ju duhet të trajtoheni mirë, të gëzoni integritet dhe të merrni informacion të rëndësishëm si dhe t'ju ofrohet liria e zgjedhjes.

Ju keni të drejtën që informacioni t'ju jepet në mënyrë të kuptueshme

Kjo përfshin gjendjen tuaj mjekësore, diagnozën e prognozën si dhe metodat e ofruara për ekzaminimin dhe trajtimin. Ju keni edhe të drejtë të merrni informacion në lidhje me afatin e pritjes, efektet dhe ndikimet anësore të shkaktuara nga barnat dhe trajtimet. Nëse jeni sëmure rëndë mund të caktoni një mik të ngushtë ose pjesëtar të familjes që t'i mbikëqyrë këto të drejta për ju.

Garancia e vizitave dhe trajtimeve

Ligji për Kujdesin Shëndetësor dhe Mjekësor përcakton se ju keni të drejtën të merrni kujdes mjekësor brenda një kohe të caktuar. Nga momenti kur ju, në konsultim me personelin e kujdesit shëndetësor, keni vendosur se duhet të shkoni e të vizitoheni në qendrën shëndetësore të rrethi ose ju duhet të merrni trajtime, garancia e kujdesit mjekësor përcakton kohën maksimale që ju duhet të prisni. Nëse sëmureni rëndë, ose pësoni një lëndim, ju do të merrni kujdes mjekësor sa më parë që të jetë e mundur.

0 Ju mund ta kontaktoni shërbimin e kujdesit parësor ose personelin në qendrën e kujdesit parësor me anë të telefonit ose mund të caktoni një vizitë të atje të njëjtën ditë.

7 Nëse personeli i kujdesit shëndetësor mendon se ju duhet të vizitoheni nga një doktor ju do t'ju caktohet një vizitë brenda shtatë ditësh.

90 Nëse jeni dërguar për trajtim nga specialisti do t'ju caktohet një takim brenda 90 ditësh. Kjo gjë aplikohet edhe kur shkoni vetë tek doktori specialist. Fëmijët dhe të rinjtë që vuajnë nga sëmundje psikike kanë të drejtën të trajtohen brenda 30 ditësh.

90 Pasi të jetë marrë vendimi rreth trajtimit ai duhet bërë brenda 90 ditësh. Fëmijët dhe të rinjtë që vuajnë nga sëmundje psikike kanë të drejtën të trajtohen brenda 30 ditësh.

Ne në Bashkinë e Rrethit Kronoberg punojnë që ju të vizitoheni nga një specialist edhe më shpejt. Është synimi jonë që ju të trajtoheni brenda 0–7–60–60 ditësh.

Nëse Bashkia e Rrethit Kronoberg nuk mund ta plotësojë garancinë për vizitat në përputhje me kriteret e sipërpërmendura ju mund të kontaktoni një ofrues tjetër shërbimi shëndetësor brenda rrethit ose në rreth tjetër. Në këto raste pagesat e pacientit dhe pagesat personale për transportin i paguani vetë.

Nëse vendosni të merrni kujdes nga një ofrues tjetër dhe jo nga Bashkia e Rrethit Kronoberg ju duhet të paguani çdo shpenzim vetë si për shembull transportin dhe akomodimin.

Një mendim i dytë – një vlerësim i dytë mjekësor

Ju në disa raste keni të drejtën të merrni një opinion të dytë mjekësor. Kjo do të thotë se mund të ekzaminoheni nga një doktor tjetër. Zakonisht personeli i kujdesit shëndetësor organizon një opinion të dytë mjekësor brenda spitalit ose duke kontaktuar një spital tjetër.

Ju keni të drejtë të merrni një opinion të dytë:

- nëse vuani nga një sëmundje vdekjeprurëse ose tepër e rëndë
- nëse trajtimi mjekësor mund të përfshijë rreziqe serioze për ju si pacient
- nëse zgjedhja juaj ka ndërlikime të mëdha në lidhje me cilësinë e jetës tuaj në të ardhmen e
- nëse nuk është e qartë se çfarë lloj trajtimi është më i përshtatshëm në rastin tuaj specifik.

Referimet

Ju duhet një referim për shembull kur doktori juaj mendon se ju duhet të takoheni me një specialist ose duhet të shkoni të vizitoheni në një spital. Ju mund të kërkoni edhe një takim të shërbimi specialist i spitaleve duke përdorur të ashtuquajturin vetë-referim. Kjo do të thotë se ju përshkruani me shkrim vetë gjendjen tuaj duke shpjeguar pse ju duhet kujdesi për shëndetin.

Nëse ju duhet kujdes shëndetësor shumë i specializuar ose ekzaminime me grafi dhe analiza laboratorit ju duhet një referim nga doktori juaj. Problemet e zemrës dhe inseminimi artificial janë shembuj të kujdesit të specializuar.

Nëse kuroheni në një bashki rrethi tjetër atëherë zbatohen rregullat përkatëse të referimit të asaj bashkie rrethi.

E drejta për përkthyes(e)

Nëse është e nevojshme ju keni të drejtën të përdorni shërbimet e një përkthyesi. Lutemi na informoni për kërkesat për një përkthyes kur caktoni vizitën tuaj. Personeli i kujdesit ndaj shëndetit do të organizojë një përkthyes nga një agjenci përkthimi.

Paaftësitë në të dëgjuar dhe në të folur

Nëse vuani nga aftësitë e kufizuara në të dëgjuar ose në të folur ose nëse nuk kuptoni suedisht ju mund të kërkonit ndihmën e një përkthyesi(eje).

Personat shurdh, shurdh-memec ose që vuajnë nga probleme serioze me dëgjimin kanë të drejtën të kërkojnë një ekspert të gjuhës së shenjave për shumicën e situatave të zakonshme. Shërbimi i përkthyesve është falas dhe mund të organizohet nëpërmjet Qendrës së Përkthyesve të Bashkisë së Rrethit.

Gjuhët e tjera përveç suedishtes

Ju keni të drejtën e një përkthyesi(eje) nëse keni nevojë. Informoni personelin kur caktoni vizitën tuaj. Personeli i kujdesit shëndetësor do të organizojë një përkthyes(e) nga Qendra e Përkthyesve të Bashkisë së Rrethit.

Ne rekomandojmë të përdorni një përkthyes të autorizuar edhe nëse keni miq apo familjarë të cilët mund të duan të përkthejnë për ju.

Teletal (tele-zëri)

Ju mund të përdorni shërbimin e Teletal kur telefononi centralin e Bashkisë së Rrethit. Teletal mund të ndihmojë ata që kanë vështirësi me të folurën, gjuhën ose gjuhët e ndryshme.

Pyetje

A keni pyetje për kujdesin tuaj shëndetësor dhe trajtimet? Nëse po, kontaktoni klinikën që ju ka kontaktuar ose përndryshe doktorin i cili dërgoi rekomandimin tek specialisti i shërbimit të përkujdesjes së shëndetit.

Nëse keni sugjerime

Nëse keni opinione ose sugjerime në lidhje me kujdesin shëndetësor që merrni lutemi kontaktoni personelin ose menaxherin drejtues në klinikën që keni vizituar. Mund të kontaktoni dhe Bordin e Pacientëve në adresën e mëposhtme.

Telefoni: 0470 58 85 42

Posta elektronike: patientnamnden@ltkronoberg.se.